



USAID

NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

INFORMATORI

Iniciativa “Rinia, e ardhmja” në Klinë

Edukimi dhe tregu i punës në Komunën e Klinës

66

Shkolla
Profesionale

.....

46

Mijë nxënës

Në Kosovë ekzistojnë gjithsej 66 shkolla profesionale, ku vijnë në mësimin 46 mijë nxënës (ParsToday, 2017). Kërkesat e tregut të punës dita ditës po orientohen më shumë nga zanatet dhe profesionet e fituara nga drejtimet profesionale krahas atyre akademike. Arsimit dhe aftësimi profesional pajis nxënësit me njohuri, shkathësi, vlera dhe qëndrime që ju mundësojnë atyre t'i plotësojnë nevojat e të sotmes dhe sfidat e së nesërme (MASHT).

Sipas Zyrës për Punësim në komunën e Klinës ka disa lloj kuadros në mungesë. Disa prej tyre janë: Agjistor/e, Kuzhinier/e, Automekanik/e, Hidroinstalues/e, Elektroinstalues/e, Arsimtar/e apo Profesor/eshë të lëndëve shkencore (matematikë, fizikë, kimi). Sipas Zyrës për Punësim këto profesione nuk kanë vëmendje të mjaftueshme, dhe si rezultat vërehet edhe mungesa e tyre në tregun e punës. Edhe pse kërkesat për profesione të tilla janë të larta në vendin tonë, gjithsesi ka numër të madh të rinjve të regjistruar si të papunë, të cilët kryesisht kanë mbaruar shkollim akademik krahas atij profesional. Vetëm gjatë muajit gusht të vitit 2021 janë regjistruar si të papunë rreth 105 persona dhe 334 punëkërkues.

Një mënyrë mjaft praktike për të qenë në hap me konkursat dhe mundësitë e punësimit në qytetin ku jeton - por edhe më gjërë - është hapja e një llogarie në Agjensionin për Punësim të Republikës së Kosovës (APRK) ku më pas bie në kontakt të drejtpërdrejt me punëdhënësin. Veç kësaj, kjo faqe e internetit përmban edhe trajnime dhe informacione tjera të dobishme për tregun e punës (Zyra e Punësimit, Klinë).

Kuadro me mungesë në komunën e Klinës në fushën e mësimdhënies, specifikisht në lëndën e matematikës dhe fizikës thuhet të ketë edhe nga Drejtoria Komunale për Arsim, e gjithashtu edhe për ligjërues në drejtimin e infermierisë në shkollën e mesme profesionale (Infermiera si drejtim i ri i hapur prej 2 vitesh). Në mungesë të një Infermieri/eje me diplomë master për të ligjëruar module të caktuara është punësuar fizioterapeut si shkak i mungesës së kuadrove dhe domosdoshmërisë për mbulim të programit (DKA, Klinë). Drejtoria e Arsimit tregon gjithashtu të ketë interesim më të madh nga nxënësit e klasave të nënta që për shkollim të mesëm ta përzgjedhin Gjymnazin krahas shkollës profesionale, tendencë kjo jo me ndonjë shpjegim logjik, edhe pse tregu i punës sot më lehtë dhe më shpejtë punëson kuadrot e dala nga drejtimet profesionale.

Disa nga drejtimet me mjaft perspektivë që ofrohen në shkollën e mesme profesionale "Fehmi Agani" në Klinë janë: Teknik/e i/e informatikës, Instalues/e elektrik/e, Instalues/e i/e Ujit dhe Kanalizimit, Automekanik/e, Operator/e Prodhimi, Laborant/e i/e Biologjisë, Teknik/e i/e Ndërtimtarisë, Ekonomi, Teknologji Ushqimore e Infermieri.

ELEKTROTEKNIKË


Teknik/e i/e informatikës, Instalues/e elektrik/e - këto janë profesione shumë të kërkuara në tregun e punës, si brenda dhe jashtë vendit. Shkolla posedon mjedis mjaft të pajisur për punë praktike dhe ka personel arsimor të profesionalizuar.



MAKINERI

Instalues/e i/e ujit dhe kanalizimit - mësoni rreth përgatitjes së lokacionit dhe mjeteve të punës për instalime të ujësjellësit dhe kanalizimit. Bëni skema të instalimeve, zbatoni rregullat e sigurisë, të higjenës dhe mbrojtjes së mjedisit.






Automekanik/e - aftësoheni dhe fitoni njohuri që lidhen me tregun e riparimeve dhe mirëmbajtjeve të automjeteve, elektronikën dhe diagnostifikimin e tyre.

Operator/e i/e komunikacionit rrugor - mësoni ecuritë teknologjike të procedurave mekanike dhe operimit në prodhim. Mësoni bazat e transportit, sigurinë në trafik, gjeografinë e transportit, transportin e udhëtarëve, shenjat e trafikut dhe sinjalizimin rrugor.

KIMI - TEKNOLOGJI




Gjeolog/e, Xehtar/e, Minator/e - mësoni t'i kryeni detyrat teknike dhe organizative në minierat sipërfaqësore dhe nëntokësore. Bëni organizimin e punës në frontin e nxjerrjes dhe e caktoni strukturën kualifikuese.

BUJQËSI



Pemëtar/e, Vreshtar/e, Kopshtar/e - Hortikulturë quhet fusha që përfshin teknikat bujqësore. Këtu mësoni bazat e tokës dhe të ushqyerit e bimëve, prodhimin dhe kultivimin e tyre.


BIOLOGJI



Laborant/e i/e biologjisë - mësoni punën në laboratorin e biologjisë i cili është i pajisur me mjete, aparate, instrumente, kimikale e materiale specifike për kryerjen e punës praktike. Mësoni si të zhvilloni disiplina të ndryshme biologjike në laborator.

NDËRTIMTARI

Teknik/e i/e ndërtimtarisë - mësoni vizatim teknik dhe gjeometri diskriptive, konstruksionet dhe materialet ndërtimore, teknologjitë e ndërtimit dhe ekonominë e organizimit ndërtimor.



.....

EKONOMI

Kontabilist/e - përveç lëndëve të përgjithshme mësoni modulet teorike profesionale si: kontabilitet, financë, statistikë, bazat e së drejtës, njohja e mallit, komunikim biznesi, marketing, afarizëm bankar dhe afarizëm komercial.



.....

TEKNOLOGJI USHQIMORE

Teknolog/e ushqimor/e - mësoni parimet themelore të prodhimit të ushqimit, fokusoheni në detajet e konstruksioneve dhe mënyrën e veprimit të aparateve prodhuese, rëndësinë e higjenes dhe shëndetësisë së ushqimit. Integroheni me parimet e tregut të punës në industrinë ushqimore. Pasi ta përfundoni këtë drejtim fitoni aftësi të mjaftueshme për të punuar në fabrikë për prodhimin e ushqimit apo industri ushqimore. Ky drejtim gjithashtu ofron mundësi vazhdimi për aftësim edhe më të lartë.



.....

INFERMIERI

Infermier/e - mbani ligjërata me ekipe profesionistësh shëndetësorë dhe keni mundësi të kryeni praktikë të mentoruara në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare. Praktika ju aftëson që t'i punoni si infermier/e e gjithashtu keni mundësinë të vazhdoni studimet e larta në infermieri ose në drejtime tjera të kujdesit shëndetësor.



Iniciativa “Rinia, e ardhmja” në Klinë mbështetet nga Agjencioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) përmes aktivitetit Up to Youth.

Up to Youth është aktivitet pesë vjeçar i përkushtuar që të përmirësojë kapacitetet e rinisë dhe të krijojë mundësi për aspiratat e rinisë, në mënyrë që ata të kontribuojnë dhe të përfitojnë nga komunitete më të qëndrueshme, më demokratike dhe më prosperuese.

Përmbajtja është përgjegjësi e Global Communities dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.